



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 287, Datë 24.10.2022

PËR  
“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR  
PROKURORIN GËZIM SPAHIU”

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Gëzim Spahiu, si trajnues në aktivitetin e organizuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, me temë “Lufta kundër qarkullimit të fondeve të paligjshme”, për periudhën kohore 27 dhe 28 Tetor 2022.
2. Të njoftohen për këtë vendim zoti Gëzim Spahiu, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 24.10.2022.

KRYETAR

Alfred Balla

